



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1854/6 prot.

Datë 05.08.2025

V E N D I M

Nr. 1009/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.08.2025 me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SH.A në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

Autoriteti Kontraktor: Sh.A Albpetrol, me adresë: Albpetrol sh.a, Rr. Fier-Patos, Km. 07.

Ankimues: Operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SHA me NIPT (J91402501L), me adresë: Zona Kadastrale 2547, Nr.Pasurie 159/182, Vol 19, Fq 219.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur:

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.06.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753-06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri

auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

II.2. Në datën 30-06-2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 04.07.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“A R B L E V” SHPK	1,650,000.00 lekë	Kualifikuar
“KAPPA - OIL” SHPK	1,202,500.00 lekë	Skualifikuar

(OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per artikujt objekt prokurimi sipas kërkesave te pikës 2.3.3. të pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 8 të DST-së, konkretisht: Autorizimi i paraqitur eshte per nje tjeter Autoritet Kontraktor. - Vlera e ofertes ekonomike e paraqitur nga OE eshte vlere anomalisht e ulet kjo ne kundërshtim me nenin 93 të LPP-së, dhe pikës 4 të nenit 82 të VKM)

II.4 Në datën 10.07.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2025/5547, datë 11.07.2025 dhe nr. Protokolli 1854/2025, datë 11.07.2025, të operatorit ekonomik “KAPPA - OIL” SHA për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1854/1 prot, datë 14.07.2025, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA - OIL” SH.A, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.7. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 3683/3 prot., datë 17.07.2025, protokolluar me tonën me nr.1854/2 prot., datë 21.07.2025, ka dërguar vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “KAPPA - OIL” SH.A. Referuar shkresës së cituar më sipër të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit

ka vendosur të refuzojë ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke argumentuar si më poshtë vijon: [...]

ARSYETIMI I ZSHA:

Referuar ligjeve për prokurimin publik, vendosjen e kriterëve të veçanta për kualifikim si kryetar që të ketë autoritet kontraktor për njohjen e aftësive dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, duke përdorur dokumentacionin e parapërgatitur, duhet të vërtetojnë se kualifikimet e domosdoshme teknike, profesionale, kapacitete ekonomike, financiare dhe organizative, makineri, mbrojtje dhe siguri të tjera fizike, reputacion dhe besim, përdorim të qëndrueshëm, si dhe personel e domosdoshme, gjithçka në funksion të realizimit të suksesit të kontratave. Kriteret e kualifikuara të kryera nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për të përmbushur të gjitha ofertat ekonomike pjesëmarrëse në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor nuk duhet të shqyrtojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është e zbatueshme me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e kryera në njoftimin e kontratave dhe në dokumentet e tenderit. Për shkak të pronësisë, operatorët ekonomikë duhet të kërkojnë hollësisht vendosjen e dokumenteve të tenderit, të cilat janë të rrëzuara, të vlerësuara dhe të kualifikuara, të cilat duhet të bëhen vetëm me këtë kërkesë.

Autorizimi i Prodhimit të paracaktuar është për një Autoritet tjetër Kontraktor, nëse nuk ka asnjë hollësi kushtuar që të ketë dokument të rregulluar.

Për shkak të pretendimit të ankimimit nuk qëndron.

ARSYETIMI I ZSHA:

Nga shqyrtimi i ofertës së ankimuesit në këtë procedurë prokurimi, rezulton se ajo është anomalisht e ulët. Gjithashtu, nga shqyrtimi i dosjes së tenderit vërehet se arsyeja e skualifikimit të OE ankimues është:

"Vlera e ofertes ekonomike e paraqitur nga OE është vlerë anomalisht e ulët kjo në kundërshtim me nenin 93 të LPP-së, dhe pikës 4 të nenit 82 të VKM."

Sipas përcaktimeve të Vendimit nr. 285, të Këshillit të Ministrave, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndyshuar, Neni 82 "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", pika 4 e këtij neni parashikohet se:

"Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve"

Nisur nga fakti që kjo procedurë prokurimi është me vlerë nën kufirin e lartë monetar, KVO ka refuzuar ofertën anomalisht të ulët, pa kërkuar sqarim nga Operatori Ekonomik, në përputhje me nenin 82 të VKM 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndyshuar, arsye të cilën ja ka deklaruar edhe ankimuesit.

Për sa më sipër pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

Bazuar në nenin 114 të ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 102 të vendimit nr. 285, të Këshillit të Ministrave, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KSHA.

VENDOSI:

*1. Të refuzojë ankesën e paraqitur nga OE "KAPPA - OIL" sha.
[...]*

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, janë dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimeve argumente shtesë nga operatori ekonomik ankimues "KAPPA - OIL" SH.A në datë 21.07.2025 protokolluar me tonën nr. 1854/3, datë 22.07.2025, për procedurën e prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "KAPPA - OIL" SHA, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, me arsyen se: *"Se pari lidhur me Autorizimin e Prodhuesit është e vertete qe gabimisht nga ana e Prodhuesit është vendos nje autoritet tjeter kontraktor por nr. References I vendosur ne autorizim ,konkretisht REF-51753-06-19-2025 ,eshti I sakte . Bazuar ne ligjin 162/2020 Per Prokurimin Publik , neni 36 , pika 2 i Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publicë si dhe pika 6 i NË rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës iaë të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor. Duke qene se nr. I references qe eshte me I rendesishmi ne nje procedure prokurimi eshte eshte I sakte dhe I perket kesaj procedure prokurimi , gabimi material lidhur me emrin e autoritetit kontraktor nuk duhet te sherbeje si pengese artificiale dhe si e tille nuk mund te konsiderohet nga autoriteti juaj kontraktor si mospermbushje te kapacitetit teknik . Duhet shtuar ketu qe oferta ekonomike e paraqitur nga ana*

e shoqerise eshte rreth 27 % me ulet se sa oferta ekonomike e OE pasardhes , duke I kursyer buxhetit nje shume te konsiderueshme , gje e cila eshte dhe qellimi dhe misioni I prokurimit public.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë: *“2.3.3Operatori ekonomik duhet te paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori te autorizuar për artikujt objekt prokurimi. Ne rast se do te paraqitet autorizim nga distributori duhet te provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Në autorizim duhet të jetë i paraqitur numri i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Distributorit (Adresë, ëbsite, email, telefon) në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet nëse do të nevojitet.”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “KAPPA” SHA, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon: *“Autorizim lëshuar nga “YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE TIC.A.S” për “KAPPA OIL” SHA me përmbajtje si më poshtë: “Cilit do qe i intereson, Per: Operatori Blerjeve te Perqendruara Tirane-Shqiperi, YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE TIC.A.S qe ndodhet ne Organize Sanayi Bölgesi Oğuz Caddesi No: 2 Sincan/ANKARA, Turkey, NIPT N. 9800034685 ne cilesine e prodhuesit dhe tregtuesit te baterive autorizon: KAPPA OIL SHA.....Te marre pjese ne tenderin me nr. REF-51753-06-2025 "Blerje bateri" me produktet tona. Ne I japim te drejta te plota KAPPAOIL SHA qe te ofroje, negocioje dhe eventualisht te nenshkruaje kontraten me ju per produktet tona.”.*

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në*

dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.5. Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim. 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose

në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.6. Në nenin Neni 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme. 2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet. 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”*

III.1.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”*

III.1.8. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje

me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për artikujt objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. ***Në autorizim duhet të jetë i paraqitur numri i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Distributorit (Adresë, ëbsite, email, telefon)*** në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet nëse do të nevojitet. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “KAPPA OIL” SHA, konstatohet se ky i fundit ka paraqitur ndër të tjera edhe Autorizim lëshuar nga “YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE TIC.A.S” për “KAPPA OIL” SHA me përmbajtje si më poshtë: *“Cilit do që i intereson, Per: Operatori Blerjeve të Perqendruara Tirane-Shqiperi, YIGIT AKU MALZ.NAK.SAN.VE TIC.A.S që ndodhet në Organize Sanayi Bölgesi Oğuz Caddesi No: 2 Sincan/ANKARA, Turkey, NIPT N. 9800034685 në cilësinë e prodhuesit dhe tregtuesit të baterive autorizon: KAPPA OIL SHA.....Te marre pjese ne tenderin me nr. REF-51753-06-2025 "Blerje bateri" me produktet tona. Ne 1 japim te drejta te*

plota “KAPPA OIL” SHA qe te ofroje, negocioje dhe eventualisht te nenshkruaje kontraten me ju per produktet tona.”. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar dokumentin autorizim prodhuesi dhe se pavarësisht që nga prodhuesi është lënë autoriteti kontraktor “Per: Operatori Blerjeve te Perqendruara Tirane-Shqiperi”, nuk ka qënë kërkesë nga vetë autoriteti kontraktor i kësaj procedure prokurimi që autorizimi të jëtë më një përmbajtje të tillë. Nisur nga kërkesa e kriterit 2.3.3. “... **Në autorizim duhet të jetë i paraqitur numri i referencës së procedurës së prokurimit si dhe të dhëna të sakta të Prodhuesit/Dristibutorit (Adresë, ëbsite, email, telefon) në mënyrë që AK të ketë mundësi të kryej verifikimet nëse do të nevojitet...**”, të gjitha të dhenat e kërkuara përsaz i përket përmbajtjes së autorizimit janë lehtësisht të dukshme që janë përbushur për nga adresa, ëbsite-i, email-i, telefoni si dhe numri i referncës së bashku me objektin. KPP, vlerëson se me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik “KAPPA OIL” SH.A është përbushur kriteri i përcaktuar në pika 2.3.3 “Kapaciteti teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës objekt shqyrtimi. Pra, referuar dokumentacionit të mësipërm, si dhe, konstatohet se dokumenti “Autorizimi prodhuesi”, rezulton se është i vlefshëm dhe në përputhje me deklaratimet e bëra nga operatori ekonomik dhe se akoma me tej i drejtohet cilit do qe i intereson, dhe ndër të tjera dhe për: Operatorin e Blerjeve të Perqendruara Tiranë-Shqipëri. KPP, gjykon se pavarësisht se cilit autoritet i drejtohet autorizimin nga prodhuesi për sa kohë autortieti kontraktor nuk e ka kërkuar në përmbajten e kriterit për autorizim një formalitet të tillë dhe për sa kohë që autorizimi është sipas përmbajtjes të përcaktuar nga vetë kërkesat e autoriteti kontraktor është një kriter i përbushur.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2 Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “KAPPA - OIL” SHA, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, me arsyen se: “...lidhur me vleren e ofertes anomalisht nga ana autoritetit tuaj kontraktor nuk eshte eshte kerkuar sqarime , bazuar ne ligjin 162/2020 Per Prokurimin Publik , neni 93 , pika 1 “Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për cmimin ose kostot e propozuara në ofertë”. Lidhur me kete po ju paraqesim shpegimet tona sipas shkreses date 08.07/2025 bashkangjitur ku argumentohen cmimet e ofertuara”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.2. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“1. Kohëzgjatja e procedurës së vlerësimit nuk duhet të kalojë 20 (njëzet) ditë për procedurat mbi kufirin e lartë monetar dhe 15 (pesëmbëdhjetë) ditë për procedurat nën kufirin e lartë monetar, përveç rasteve të tjera të cilësuar ndryshe në këto rregulla. Në rast se komisionit të vlerësimit të

ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar, me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve.

2. Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuar në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuar në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë.

3. Ofertat e kualifikuara verifikohen nëse kanë apo jo gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike korrigjohen në mënyrën e mëposhtme: a) Nëse ka ndonjë mospërputhje, ndërmjet çmimit për njësi dhe çmimit total, që del nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. b) Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. c) Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet fjalëve dhe shifrave, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur shuma në fjalë ka lidhje me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas shkronjave “a” dhe “b”, të kësaj pike, për rrjedhojë, në këtë rast, mbizotëron shuma në shifra dhe ajo në fjalë do të korrigjohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur: - shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar; - shuma absolute e të gjitha korrigjimeve janë më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.”.

III.2.3. Nga shqyrtimi i ofertës ekonomike të operatorit ekonomik ankimues “KAPPA OIL” SHA, Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin se, në rastin konkret, në zbatim të nenit 82 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, se: *“komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.”*, dhe arsyen se skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor OE nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi per artikujt objekt prokurimi sipas kërkesave te pikës 2.3.3. të pikës 2.3 “Kapaciteti Teknik” të shtojcës 8 të DST-së, konkretisht: Autorizimi i paraqitur eshte per nje tjetër Autoritet Kontraktor.

- Vlera e ofertes ekonomike e paraqitur nga OE eshte vlere anomalisht e ulet kjo ne kundërshtim me nenin 93 të LPP-së, dhe pikës 4 të nenit 82 të VKM rezulton që operatori ekonomik ankimues nuk ka qënë ndër operatorët e kualifikuar për të vijuar me futjën e ofertës së tij në formulën e përlogaritjes së ofertave anomalisht të ulet nga autoriteti kontraktor sipas pikës 4 të nenit 82 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se arsyeja e skualifikimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit të ofertave për ofertën e dorëzuar nga operatori ekonomik “KAPPA OIL” SHA si anomalisht të ulët nuk mund të jepet në atë fazë të procedurës së prokurimit, pasi vetëm ofertat e kualifikuara për kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të dokumentave të tenderit i nënshtrohen verifikimit të mëtejshëm nëse ato janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar, ndaj në rastin konkret operatori ekonomik “KAPPA OIL” SHA nuk duhet të ishte futur në formulën e përlogaritjes nga autoriteti kontraktor për ofertat anomalisht të ulëta pasi në bazë të ofertave të vlefshme dhe të kualifikuara përcaktohet dhe menyra e përlogaritjes nëse janë ose jo me çmim anomalisht të ulët. Përsa mësim, KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori ekonomik do të ndryshojë pas ankimit në KPP, dhe autoriteti kontraktor do të rivlersojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues duke e kualifikuar atë për kriteret e përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit dhe për rrjedhojë do të ri-aplikojë menyrën e e përlogaritjes së ofertës anomalisht të ulët sipas nenit 82 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “KAPPA OIL” SHA nuk do të merrë në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë sëshkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*KAPPA OIL*” SHA, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-51753- 06-19-2025, me objekt: “Blerje bateri auto”, me fond limit 1,661,100.00 lekë pa TVSH, zhvilluar në datë 30-06-2025 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Albpetrol.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi, për operatorin ekonomik “*KAPPA OIL*” SHA.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*KAPPA OIL*” SHA” Shpk.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

